



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA TEPELENË  
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 2154 prot.

Tepelenë, më 19.10.2023

## NJOFTIM PËR KONSULTIMIN PUBLIK

<b>Titulli dhe kodi i Projektaktit:</b>	Miratimi i Paketës Fiskale dhe Planifikimi për Buxhetin e vitit 2024 të Bashkisë Tepelenë.
<b>Takimi Publik:</b>	Konsultimet publike do të organizohen sipas kalendarit bashkëlidhur këtij njoftimi.
<b>Të ftuar:</b>	Të gjithë banorët e territorit të Bashkisë Tepelenë, përfaqësues të shoqërisë civile, grupe interesi, OJF, Media, Kryetarët e fshatrave dhe ndërlidhësit komunitarë, grupe vulnerabël, përfaqësues të shoqatës së personave me aftësi të kufizuar etj.
<b>Pjesëmarrës nga Bashkia:</b>	Kryetari i Bashkisë, Kryetari i Këshillit Bashkiak, Drejtorja e Financës, Drejtorja Juridike, Administratorët e Njësive Administrative, Sekretarja e Këshillit Bashkiak, Koordinatori për informim dhe Konsultimin Publik, Këshilltarë të Këshillit Bashkiak.
<b>Drejtuesi i takimit Publik:</b>	Kryetari i Bashkisë Tepelenë z. Tërmet Peçi.

Nr.	Informacioni për publikun	Përshkrimi
1	Qëllimi i këshillimit publik	Nëpërmjet konsultimit dhe bashkëbisedimit me banorët dhe grupet e synuara Bashkia Tepelenë ka për qëllim mbledhjen e sugjerimeve dhe rekomandimeve nga komuniteti lidhur me Paketën Fiskale dhe Planifikimin e Buxhetit për vitin 2024
2	Përshkrimi i çështjes që trajton Projektakti	Në mbështetje dhe në zbatim të nenit 18 dhe nenit 54, shkronja “e” të Ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar; në zbatim të Rregullores së Këshillit Bashkiak për Konsultimet Publike, si dhe në zbatim të Ligjit 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; Ligjin 68/2018 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”; Ligji nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe Konsultimin Publik”, Këshilli Bashkiak Tepelenë do të organizojë seanca këshillimi dhe dëgjimi me Banorët për diskutimin paketës Fiskale dhe Planifikimin e Buxhetit për vitin 2024 të Bashkisë Tepelenë
3	Projektakti dhe relacionin shoqërues	Materiali i ngarkuar në <a href="http://www.tepelena.gov.al">www.tepelena.gov.al</a>
4	Pyetjet që ngre Këshilli ndaj Publikut	A mendoni se prioritetet e parashikuara në këtë draft Program janë në përputhje me ato që ju konsideroni prioritate? Cilat janë sugjerimet tuaja për të përmirësuar/ndryshuar këtë draft Program? Cfarë konsideroni se duhet shtuar në këtë draft Program?
5	Grupet e interesit, strukturat komunitare me të cilat do të konsultohet Projektakti	Banorë të Bashkisë Tepelenë dhe Njësive Administrative
6	Nj.A., Lagjet, Fshatrat ku do të mbahen takimet publike apo që ftohen të dërgojnë komente dhe rekomandime	Bashkia Tepelenë, sipas kalendarit bashkëlidhur
7	Kalendari i takimeve dhe dëgjësive publike	Kalendari i datave, vendeve dhe orëve është i përcaktuar në kalendarin bashkëlidhur këtij njoftimi. Për çdo lloj komunikimi, jeni të lutur të kontaktoni nëpërmjet postës elektronike: <a href="mailto:info@tepelena.gov.al">info@tepelena.gov.al</a>

8	Kontaktet dhe afatet e dërgimit të komenteve dhe rekomandimeve	<p>Komentet dhe rekomandimet tuaja i mirëpresim brenda datës 06.11.2023.</p> <p>Nëpërmjet <b>pjesëmarrjes tuaj në takimin publik.</b></p> <p>Mund t'i dërgoni me <b>Postë elektronike (e-mail)</b> në adresën: <a href="mailto:Valbona.Cela@tepelena.gov.al">Valbona.Cela@tepelena.gov.al</a> ose <a href="mailto:info@tepelena.gov.al">info@tepelena.gov.al</a> ose me <b>Postë fizike</b> në adresën: Këshilli Bashkiak, Bashkia Tepelenë, Sheshi “Lord Bajron”, Kodi postar 6301</p>
9	Çfarë do të vijojë pas kësaj faze këshillimi	Pas përfundimit të këtij konsultimi publik, Këshilli Bashkiak do të dërgojë tek Kryetari i Bashkisë dhe Drejtoritë përkatëse një shkresë, me të gjitha rekomandimet e nxjerra nga kjo dëgjese publike

## KALENDARI I ZHVILLIMIT TË KONSULTIMEVE PUBLIKE ME BANORËT E BASHKISË TEPELENË:

NR	NJËSIA ADMINISTRATIVE	DATA	ORA	VENDI
1	Qendër Tepelenë dhe Tepelenë	10.11.2023	10:00	Pallati Kulturës Tepelenë
2	Lopës	07.11.2023	10:00	Fshati Sinanaj
3	Kurvelesh	08.11.2023	10:00	Fshati Progonat

**KRYETARI I KËSHILLIT TË BASHKISË**

**Arben Gumeni**